

*Seancës Plevale
23/11/2022*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
NR 3972 DATE 23.11.22

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2022

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtar: Znj. Lindita NIKOLLA

Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

E nderuar Znj. Kryetare,

Bazuar në nenin 81 pika 1, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqesim projekligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”.

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

KLEVIS XHOXHI

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9917, DATË 19.5.2008, “PËR
PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozim deputeti,
KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Togfjalëshi “*Ky ligj ka për qëllim të parandalojë pastrimin e parave*” ndryshohet në “*Ky ligj ka për qëllim të parandalojë dhe të zbulojë pastrimin e parave*”
-

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në pikën 1 togfjalëshi “*Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave*” ndryshohet në “*Agjencia e Inteligencës Financiare (AIF)*”

Neni 3

Në nenin 21 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në pikën 1, fjalia e parë, togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” ndryshohet në “Agjencia e Inteligjencës Financiare”
- Në pikën 1, fjalia e dytë, togfjalëshi “Kjo drejtori” ndryshohet në “Kjo agjenci”
- Në pikën 1/1, fjalia e parë dhe e dytë, togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” ndryshohet në “Agjencia e Inteligjencës Financiare”
- Në pikën 2, fjalia e parë, togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” ndryshohet në “Agjencia e Inteligjencës Financiare”
- Pika 3 ndryshohet me përbajtjen si vijon:

“3. Marrëdhëniet e punës së Drejtoreve të Përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë rregullohen në bazë të Kodit të Punës.”
Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës Financiare, përveç përfitimeve që rrjedhin nga legjislacioni për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, gjëzon të drejtën e përfitimeve të tjera shtesë, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin përkatës për sigurimet shoqërore suplementare. Për efekt të përfitimit të sigurimeve shoqërore suplementare, si vjetërsi shërbimi njihet periudha nga momenti i emërimit deri në momentin e lirimit, shkarkimit ose largimit nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.”
- Pas pikës 3, shtohen pikat 3/1, 3/2, 3/3 dhe 3/4, me përbajtjet si më poshtë vijon:

“3/1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

“3/2”. Paga e punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës Financiare përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune. Paga bazë e Drejtoreve të Përgjithshëm është e barabartë me pagën bruto të Drejtoreve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen pagat e punonjësve të tjerë të Agjencisë së Inteligjencës Financiare si dhe shtesa për vështirësi pune për secilin kategorji.”.
- Në pikën 5, fjalia e parë dhe e dytë, togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” ndryshohet në “Agjencia e Inteligjencës Financiare”
- Pika 5, germa “c” ndyshon si vijon:

“c) organizon, kryen prokurimet dhe lidh kontratat për sistemet kompjuterike, mirëmbajtjen e tyre, për të gjitha kontratat, përfshirë dhe ato të klasifikuara, sipas legjislacionit në fuqi;”

Neni 4

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në fjalinë e parë, togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” ndryshohet në “Agjencia e Intelligencës Financiare”
- Në germën “b”, togfjalëshi “ka akses të drejtpërdrejtë” ndryshohet në “ka akses të drejtpërdrejtë pa pagesë”
- Në germën “dh”, togfjalëshi “që kryen funksione dhe u nënshtronhet detyrimeve të ngashme të konfidencialitetit” ndryshohet në “apo organizza të tjera jashtë vendit, që iu nënshtronhet detyrimeve të ngashme të konfidencialitetit”

Neni 5

Në nenin 22/1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në fjalinë e parë, togfjalëshi “DPPP-ja” ndryshohet në “Agjencia e Intelligencës Financiare”
- Në fjalinë e dytë, togfjalëshi “Drejtorinë e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” ndryshohet në “Agjencinë e Intelligencës Financiare”

Neni 6

Pas nenit 22/1 shtohet nenit 22/2 me përbajtje si vijon:

Neni 22/2

Aksesi në të dhënat në fushën e komunikimeve elektronike

1. Në zbatim të funksioneve dhe detyrave të parashikuara në ligj, Agjencia e Intelligencës Financiare mund të kërkojë informacion, të dhëna dhe dokumente të plota nga operatorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas legjisacionit për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, sa lidhet me identifikimin e klientëve apo abonentëve, mbi pikat fundore të rrjetit të shërbimit të aksesit në internet.

2. Operatorët iu përgjigjen kërkësave të Agjencisë e Intelligencës Financiare pa zvarritje, brenda 10 ditëve kalendarike dhe në raste urgjente brenda një afati më të shkurtër.”

Neni 7

Në nenin 27 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në pikën 3, germa “b”, togfjalëshi “16 e 21/1,” ndryshohet në “16, 21/1 dhe 22/2.”

- Pika 9 ndryshon si vijon “*Masat administrative përcaktohen dhe vendosen nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.*”
- Në pikën 10, pas fjalisë së dytë, shtohet fjalë si vijon “*Masa e kamatëvonesës për gjobat e vendosura nuk mund të kalojë vlerën e gjobës*”;

Neni 8

Në nenin 29 shtohet paragrafi me përbajtje si vijon:

Ndryshimi i emërtimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në Agjencinë e Inteligjencës Financiare nuk cenon drejtat dhe funksionet e strukturës si dhe realizohet në përputhje edhe me detyrimet për bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar. Të gjitha aktet nënligjore, përfshire marrëveshjet e bashkëpunimit, me struktura brenda dhe jashtë vendit, të nënshkruara nga Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, në zbatim të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, zbatohen deri në zëvendësimin e tyre me akte të tjera në zbatim të këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYETARE

LINDITA NIKOLLA

Miratuar datë _____